



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 20

Prishtinë, më 23.5.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj, Lutfi Zharku, Andin Hoti, Danush Ademi, Ganimete Musliu, Salih Salihu, Srđan Mitrović, Liburn Aliu, Driton Çausi.

Munguan: Besa Gaxherri dhe Enver Hoti.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi, Editë Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi, **Daut Haradinaj**, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 15 dhe 22 maj 2018;**
2. **Shqyrtimi i Projektligjit për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje;**
3. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshime, me kërkesë të kryetarit të komisionit Daut Haradinaj dhe me pajtimin e anëtarëve tjerë të Komisionit, që të shqyrtohet edhe Projektligji për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 15 dhe 22 maj 2018

Kryetari i komisionit konstatoi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 15 dhe 22 maj 2018.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.

Kryetari Daut Haradinaj, informoi anëtarët e Komisionit se ky Projektligj inicuar nga Komisioni i’u është shpërnda deputetëve dhe bashkë me të ka ardhë opinionin e Qeverisë me komente. **Deputetja Ganimete Musliu** tha se duhet të miratohet sa më parë ky ligj në mënyrë që të mos mbetet peng ndërhyrja në kullat e familjes Jashari, pasi që drejtori i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, në Komision kishte thënë se kjo ndërhyrje mund të bëhet vetëm pas miratimit të këtij ligji.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se me 8 vota për dhe 1 abstenim vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet, në parim, Projektligji nr. 06/L-059 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje

Kryetari Daut Haradinaj në fillim përgëzoi grupin punues me kryesuesin **Liburn Aliun** për punën e kryer dhe potencoi se ligjet e miratuara në Kuvend janë të gjitha me rëndësi por ky do të jetë në veçanti i rëndësishëm ngase ka kërkesa të panumërta nga qytetarët për miratimin sa më urgjent. Ai ja dha fjalën kryesuesit të grupit punues për të arsyetuar amendamentet e grupit dhe çështjet tjera me rëndësi rreth këtij ligji i cili pritet të zëvendësoj të mëparshmin që i ka skaduar afati. Liburn Aliu në fillim tha se në grupin punues janë shqyrtuar të gjitha amendamentet e propozuara nga GP LS dhe vërejtjet nga OSBE dhe zyra e Kuvendit për standardizim dhe potencoi faktin se ligji i vjetër të cilit i ka skaduar afati ka dhënë përvoja të mira por jo edhe rezultate të mira, ndaj me këtë ligj përfundimisht pritet që procesi i legalizimit të vazhdoi edhe më mirë se deri tani dhe me kosto ma të vogël për qytetarë dhe kompani, banorët e rinj etj. Në vazhdim ai arsyetoi 9 amendamentet e grupit punues dhe mospërkrahjen e propozim amendamenteve të GP.LS. Për 4 amendamente të GP.LS (për Nenet 13,14,15 dhe 16) tha se GP ka reformuluar tekstet e këtyre neneve por nuk janë miratuar ashtu si janë parashtruar për shkak të aplikimit më të mirë në praktikë. Për mospërkrahjen e propozim amendamenteve tjera të GP.LS tha se grupi punues u nisë nga fakti se janë jo-konkrete dhe me shumë fjalë jo të zbatueshme në aspektin ligjor gjithashtu krijojnë duplifikime të fjalorit të ligjit dhe interpretime të ndryshme. Esenca e qëndrimit të Grupit të punës lidhur me këto amendamente të GP.LS. ka qenë se pa u sqarua pronësia nuk do të ketë legalizim dmth rastet kontestuese dërgohen tek lista e pritjes pa marr parasysh sa janë kontestuese, prandaj edhe nuk janë përkrahur amendamentet. **Kryetari** ndërhyri me pyetjen rreth ndarjes së kategorive për të cilat z. Aliu tha se disa janë për MMPH e disa janë për Komuna, për këtë arsye janë ndarë në kategorinë e 3 dhe 2. Në vazhdim Liburn Aliu një nga një arsyetoi amendamentet e grupit punues kurse poashtu një nga një arsyetoi mospërkrahjen e grupit punues për 19 amendamente të GP.LS.

Në fund **Kryetari** ja dha fjalën nënkryetarit **Srdan Mitrović** si përfaqësues i LS i cili shprehu mospajtimin e Grupit Parlamentar të LS me punën e grupit punues ngase nuk janë përkrahur amendamentet dhe qëndrimet shumë të arsyeshme të këtij grupi parlamentar të cilat shprehin problemet të cilat i ka Kosova lidhur me pronësi përkatësisht pronësinë e bashkësisë serbe. Pastaj kryetari ftoi komisionin për deklaram, dhe Komisioni **me 8 vota për dhe 1 kundër, nxori këtë:**

P Ë R F U N D I M

1. Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje dhe i procedohet komisioneve të përhershme për vlerësim.

Amendamenti 1

Në **Nenin 1**, nën-paragrafi 1.3 dhe në tërë projektligjin, emërtimi “**sporteli të vetëm (One Stop Shop)**” zëvendësohet me: “**zyreje të vetme shërbyese**”.

Amendamenti 2

Neni 3, nën-paragrafi 1.15.1, pas fjalës “ndërtimore” fshihet ”apo leje tjetër” dhe vazhdon teksti si në projektligj.

Në nën-paragrafin 1.19. referencat: “**paragrafi 4.1.**” dhe “**paragrafi 1.5.**” bëhen “**nën-paragrafi 4.1**” dhe “**nën-paragrafi 1.5.**”.

Pas nën-paragrafit 1.36, shtohen 2 nën-paragrafë të rinjë:

1.37. **Certifikata e përdorimit** – siç është përkufizuar në Ligjin në fuqi për ndërtim.

1.38. **Hostimi** - Vendosija e platformës softverike në pajisjet hardverike.

Amendamenti 3

Neni 4, në nën-paragrafin 2.2. pas shkurtesës “RDPP” shtohet: „në pajtim me legjislacionin në fuqi“

Amendamenti 4

Neni 13, nën-paragrafi 3.2. referenca “**paragrafi 1.1**” bëhet “**nën-paragrafi 1.1**”

Paragrafi 5, riformulohet si në vijim:

5. Nëse organi kompetent vlerëson se aplikacioni është i kompletuar dhe ndërtimi pa leje kualifikohet për legalizim sipas këtij Ligji, organi kompetent:

5.1. legalizon ndërtimin pas pagesës së taksës së përcaktuar në nenin 20 të këtij Ligji;

5.2. shënon ndërtimin si “i legalizuar” në Bazën e të Dhënave të Legalizimit pas pagesës së taksës përkatëse sipas nenit 20 të këtij Ligji;

5.3. regjistron ndërtimin pa kosto shtese në Kadastër, me një shënim se është i legalizuar sipas këtij Ligji;

5.4. regjistron të drejtën pronësore mbi parcelën ndërtimore në RDPP pa kosto shtesë edhe nëse pronari i ndërtimit nuk është pronar i regjistruar i parcelës ndërtimore,por qëofron dokumentacion të mjaftueshëm për regjistrim në RDPP sipas legjislacionit në fuqi;

5.5. lëshon certifikatën e legalizimit dhe dokumentet përkatëse që vërtetojnë regjistrimin në Kadastër dhe në RDPP brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas dorëzimit të aplikacionit të kompletuar nga aplikuesi.

Amendamenti 5

Neni 14, paragrafi 3 riformulohet si në vijim:

3. Nëse organi kompetent vlerëson se aplikacioni është i kompletuar dhe ndërtimi pa leje kualifikohet për legalizim siç parashihet me këtë ligj, organi kompetent:

3.1. përcakton nëse ndërtimi pa leje është në përputhje me kërkesat themelore për shëndet dhe siguri të përcaktuara në aktin nënligjor të miratuar sipas nenit 24, nënparagrafi 1.1 të këtij Ligji dhe me dispozitat tjera të këtij Ligji;

3.2.legalizon ndërtimin pas pagesës së taksës së përcaktuar në nenin 20 të këtij Ligji;

3.3. shënon ndërtimin si “i legalizuar” në Bazën e të Dhënave të Legalizimit pas pagesës së taksës përkatëse sipas nenit 20 të këtij Ligji;

3.4. regjistron ndërtimin pa kosto shtese në Kadastër, me një shënim se është i legalizuar sipas këtij Ligji;

3.5. regjistron të drejtën pronësore mbi parcelën ndërtimore në RDPP pa kosto shtesë edhe nëse pronari i ndërtimit nuk është pronar i parcelës ndërtimore, por që ofron dokumentacion të mjaftueshëm për regjistrim në RDPP sipas legjislacionit në fuqi;

3.6. për ndërtesat me shumë njësi banimi, pa kosto shtesë, formon njësi kadastrale për pjesët e ndërtesës dhe u cakton numrat njësive;

3.7. pas legalizimit të njësive në ndërtesat pa leje sipas nënparagrafit 3.6 të këtij neni mund të regjistron të drejtat pronësore të pronarëve të ndërtimit pa lejenë RDPP pa kosto shtesë brenda një (1) viti kalendarik;

3.8. regjistron marrëveshjen për bashkëpronësi në Kadastër dhe/ose RDPP pa kosto shtesë për ndërtesat me shumë njësi banimi të organizuara si ndërtesa në bashkëpronësi, sipas Ligjit në fuqi për ndërtesat në bashkëpronësi; dhe

3.9. lëshon certifikatën e legalizimit dhe dokumentet përkatëse që vërtetojnë regjistrimin në Kadastër dhe në RDPP brenda nëntëdhjetë (90) ditëve pas dorëzimit të aplikacionit të kompletuar nga aplikuesi.

Amendamenti 6

Neni 15, paragrafi 7 riformulohet si në vijim:

7. Pasi të përfundohet ndërtimi i papërfunduar pa leje, organi kompetent kryen inspektimin e fundit dhe nëse vlerëson se ndërtimi përputhet me kushtet e caktuara në lejen e legalizimit për përfundim të ndërtimit, organi kompetent:

7.1. lëshon certifikatën e legalizimit;

7.2. regjistron ndërtimin pa kosto shtesë në Kadastër, me një shënim se është i legalizuar sipas këtij Ligji;

7.3. regjistron të drejtën pronësore mbi parcelën ndërtimore në RDPP pa kosto shtesë edhe nëse pronari i ndërtimit nuk është pronar i parcelës ndërtimore, por që ofron dokumentacion të mjaftueshëm për regjistrim në RDPP sipas legjislacionit në fuqi; dhe

7.4. lëshon certifikatën e legalizimit dhe dokumentet përkatëse që vërtetojnë regjistrimin në Kadastër dhe në RDPP brenda tridhjetë (30) ditëve.

Amendamenti 7

Neni 16, paragrafi 3 riformulohet si në vijim:

3. Nëse, organi kompetent vlerëson se aplikacioni është i kompletuar dhe ndërhyrja pa leje kualifikohet për legalizim sipas këtij Ligji, organi kompetent:

3.1.përcakton nëse ndërhyrja pa leje është në përputhje me kërkesat themelore për shëndet dhe siguri të përcaktuara në aktin nënligjor të miratuar sipas nenit 24, nënparagrafi 1.1 të këtij Ligji dhe me dispozitat tjera të këtij Ligji;

3.2. legalizon ndërhyrjen pa leje pas pagesës së taksës së përcaktuar në nenin 20 të këtij Ligji;

3.3. shënon ndërhyrjen pa leje si “e legalizuar” në Bazën e të Dhënave të Legalizimit pas pagesës së taksës përkatëse sipas nenit 20 të këtij Ligji;

3.4. regjistron ndërtimin pa kosto shtesë në Kadastër, me një shënim se është i legalizuar sipas këtij Ligji;

3.5. regjistron të drejtën pronësore mbi parcelën ndërtimore në RDPP pa kosto shtesë edhe nëse pronari i ndërtimit nuk është pronar i parcelës ndërtimore, por që ofron dokumentacion të mjaftueshëm për regjistrim në RDPP sipas legjislacionit në fuqi; dhe

3.6. lëshon certifikatën e legalizimit dhe dokumentet përkatëse që vërtetojnë regjistrimin në Kadastër dhe në RDPP, brenda nëntëdhjetë (90) ditëve.

Amendamenti 8

Neni 24, nën-paragrafi 1.5, plotësohet dhe riformulohet si në vijim: „procedurat e ankesave kundër vendimeve për trajtimin e ndërtimeve pa leje“.

Amendamenti 9

Neni 25, fshihet.

2. Amendamentet e Grupit Parlamentar Lista Serbe, pa përkrahjen e Komisionit funksional :

Amendamenti I

Ndryshohet neni 22 paragrafi 4 i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje, si në vijim:

Në Komisionin për ankesa dhe trajtimin e ndërtimeve pa leje do të përfaqësohen edhe përfaqësuesit e komunitetit Serb, si dhe përfaqësuesit e komuniteteve tjera jo shumicë.

ARSYETIM

Është e nevojshme që të respektohet karakteri multietnik i Kosovës, mirëpo edhe neni 61 i Kushtetutës së Kosovës thekson si në vijim: “Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë në përfaqësim të drejtë me rastin e punësimit në organet publike dhe ndërmarrjet publike në të gjitha nivelet”. Gjithashtu çështja e pronës së paluajtshme dhe legalizimi i saj është me rëndësi të madhe për popullsinë serbe në Kosovë. Meqë zhvillimi i komunave me shumicë serbe dhe interesat tjera vitale, siç është e drejta në kthim, varen nga zgjidhja e statusit të pronës, interesi i arsyeshëm i komunitetit serb në Kosovë është që të ketë përfaqësuesit e sajë në Komisionin për ankesa dhe trajtimin e ndërtimeve pa leje.

ME RËNDËSI

Miratimi i këtij amendamenti kërkon plotësimin e tekstit në versionin në gjuhën shqipe dhe angleze, përkatësisht shtimi i tekstit të theksuar në amendament.

Amendamenti II

Neni 22 paragrafi 4 i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje bëhet neni 22 paragrafi 5.

ARSYETIM

Pasojat e amendamentit I.

E RËNDËSISHME

Miratimi i këtij amendamenti kërkon plotësimin e tekstit në versionin në gjuhën shqipe dhe angleze, përkatësisht shtimi i tekstit të theksuar në amendament.

Amendamenti III

Neni 2 të Projektligjit shtohet paragrafi 7 si në vijim:

Ky ligj nuk zbatohet në objektet të cilat janë ndërtuar në tokën e uzurpuar, tokën në pronësi të personave të shpërngulur, si dhe në tokën tjetër pa njohurinë ose lejen e pronarit ose në kundërshtim me ndalimin e rreptë të pronarit, pa marr parasysh nëse kjo tokë është klasifikuar si tokë ndërtimore, private apo tokë tjetër.

ARSYETIM

Qysh në pjesën hyrëse, është e nevojshme që të përcaktohet si Ligji nuk zbatohet në ndërtimet të cilat janë ndërtuar me shfrytëzimin e argumentuar se toka është e uzurpuar apo pronari ka qenë i detyruar për të ikur nga toka e tij. Me vendosjen e këtij standardi qysh në fillim, Ligji do të përcaktohet për respektimin e mbizotërimit të drejtës, në vend që parimi i legalizimit i asaj që ka ardhur me dhunë në rrethana të kundërligjshme. Ky paragraf gjithashtu është në përputhje me rezonimin e drejtë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në lëndën KI187/13 më 16.04.2014.

ME RËNDËSI

Miratimi i këtij amendamenti kërkon plotësimin e tekstit në versionin në gjuhën shqipe dhe angleze, përkatësisht shtimi i tekstit të theksuar në amendament.

Amendamenti IV

Neni 2 të Projektligjit i shtohet paragrafi 8 si në vijim:

Ky Ligj nuk zbatohet në objektet të cilat janë ndërtuar në tokën ndërtimore urbane në të cilën më parë ka ekzistuar një patundshmëri tjetër, e cila është rrënuar si pasojë e veprimit të njeriut, gjatë ose pas konfliktit, çrregullimeve ose akteve jo legale individuale, e as objekte të cilat kanë lindur me mbindërtime, me restaurim apo me ndryshimin në ndonjë mënyrë tjetër të objektit i cili është në pronësi të personave të shpërngulur, përkatësisht në pronën e uzurpuar, në të cilën pronarët nuk janë në gjendje të kenë qasje.

ARSYETIM

Meqë Kosova edhe më tutje, mbi 15 vjet pas konfliktit nga viti 1999, përkatësisht afro 14 vite pas ndjekjes nga muaji mars 2004, nuk ka zgjidhur çështjen e patundshmërive të rrënuara ose të uzurpuara, nuk është e mundur të legalizohet çfarëdo prone qoftë e cila është krijuar si pasojë e shkeljes të të drejtave masive, në mënyrë që mos të rrënohet i gjithë rendi juridik në të cilin bazohet sistemi juridik i Kosovës. Është e pamundur që të legalizohet çfarëdo prone qoftë në të cilën është arritur përmes rrugës jo legale, me shkatërrimin apo uzurpimin e të drejtave të huaja, duke shfrytëzuar rrethanat e luftës apo të dhunës masive, meqenëse kjo nuk është në përputhje me obligimet ndërkombëtare të cilat i ka marr Kosova. Kosova është pajtuar, në mes të tjerave edhe me parimet Pinjero të cilat do të shkeleshin në mënyrë të drejtpërdrejtë me lejimin e legalizimit të pronës, te e cila është ardhur në këtë mënyrë.

ME RËNDËSI

Miratimi i këtij amendamenti kërkon plotësimin e tekstit në versionin në gjuhën shqipe dhe angleze, përkatësisht shtimi i tekstit të theksuar në amendament.

Amendamenti V

Nenit 7 të Projektligjit i shtohet paragrafi 3, si në vijim:

Asgjë nga ky nen nuk mund të interpretohet po që se miratohet kërkesa e çfarëdo personi qoftë për legalizim të patundshmërisë e cila është ndërtuar në patundshmëritë e uzurpuara, pastaj patundshmëritë e të cilave pronarët nga çfarë do arsye qoftë nuk kanë qasje, me ndryshimin ose mbindërtimin e pjesëve të patundshmërive të cilat janë uzurpuar apo në të cilat pronarët nuk kanë qasje për shkaqe objektive, si dhe ndërtimi në vendin e patundshmërive të cilat kanë qenë të ndërtuara në tokën ndërtimore urbane, por janë rrënuar si pasojë e veprimit të njeriut gjatë ose pas konfliktit, çrregullimeve ose akteve individuale jo legale.

ARSYETIM

Në mënyrë që të parandalohen cilat do qofshin keqpërdorimet eventuale, te të cilat gjithsesi në procesin e legalizimit mund të vijnë, është e nevojshme që të theksohet kudo që është e mundur obligimi i organeve komunale dhe organeve të tjera që të kenë kujdes për këtë, në mënyrë që prona e cila ka qenë lëndë e çfarëdo keqpërdorimi qoftë nuk guxon të legalizohet pa lejen e pronarit të vërtetë të patundshmërisë, përkatësisht që vepra penale nuk guxon të legalizohet, kurdo që ka ndodhur ajo. Vetëm në këtë mënyrë mund të respektohen qëllimet e proklamuar e sundimit të së drejtës dhe mbrojtjes së pronës private, të cilat vlejné për të gjithë banorët e Kosovës ose pronarët e patundshmërive në Kosovë, pa marrë parasysh prejardhjen e tyre fetare apo nacionale.

ME RËNDËSI

Miratimi i këtij amendamenti kërkon plotësimin e tekstit në versionin në gjuhën shqipe dhe angleze, përkatësisht shtimi i tekstit të theksuar në amendament.

Amendamenti VI

Nenit 6 të Projektligjit i shtohet pika 1.15. si në vijim:

Ndihmesa Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për identifikimin e objekteve të cilat janë ndërtuar në tokën e uzurpuar, tokën e pronarëve të personave të shpërngulur, si dhe në tokën tjetër pa njohuri ose lejen e pronarit.

ARSYETIM

Meqenëse uzurpimi dhe ndërtimi jo legal në tokën e personave të shpërngulur, përveç mungesës së sigurisë është njëri nga shkaqet kryesore për rezultate të dobëta të kthimit të personave të shpërngulur në Kosovë në mënyrë që të respektohet parimi i sundimit të ligjit, për pronën e personave të shpërngulur ose të personave të cilët jetojnë në Kosovë, por që nuk kanë qasje në pronë, është e nevojshme që të bëhet regjistrimi, siç është propozuar në Amendamentin XIII dhe me këtë tu lehtësohet puna të gjitha organeve të cilat marrin pjesë në procedurën e legalizimit, në mënyrë që të jenë të njoftuar që kjo pronë nuk guxon të jetë lëndë e një legalizimi të tillë. Duke pasur parasysh se komunat kanë mundësi që të sigurojmë të dhëna më të shumta për patundshmëritë e të cilat janë ndërtuar në mënyrë jo legale në pronën e uzurpuar të personave të shpërngulur ose të personave të cilët edhe më tutje jetojnë në Kosovë, por nuk kanë qasje në pronë, është e domosdoshme që të bashkëpunojmë me Ministrinë për hartimin e bazës së të dhënave për patundshmëritë të ndërtuara në tokën e personave të shpërngulur.

ME RËNDËSI

Miratimi i këtij amendamenti kërkon plotësimin e tekstit në versionin në gjuhën shqipe dhe angleze, përkatësisht shtimi i tekstit të theksuar në amendament.

Amendamenti VII

Nenit 10, i shtohet pika 1.6 si në vijim:

Në pronën e paluajtshme e cila ka qenë ose edhe më tutje është lëndë e uzurpimit, përkatësisht prona të cilës pronarët nga çfarë do arsye qofshin nuk kanë qasje në të, si dhe në tokën urbane në të cilën patundshmëri janë ndërtuar, por të cilat janë rrënuar si pasojë e veprimit të njeriut gjatë ose pas konfliktit, çrregullimeve ose akteve jo legale të individëve.

ARSYETIM

Në mënyrë që të parandalohet çfarëdo lloji i keqpërdorimeve në procedurën e legalizimit, është e nevojshme që të përcaktohet në mënyrë të qartë që kjo pronë nuk guxon të jetë lëndë e legalizimit. Ndonëse dispozita e paragrafit 2 e këtij neni mund të interpretohet në atë mënyrë që të përfshijë përveç të tjerash edhe këtë pronë, konsiderojmë se është hartuar në mënyrë jo të saktë, edhe se mbrojtjen e plotë të tyre pronarët e kësaj prone mund ta përfitojmë vetëm atëherë kur ekziston ndalimi i qartë dhe i padyshimtë i legalizimit, pas së cilit vetëm atëherë mund të zbatohet paragrafi 2 i këtij ligji, në mënyrë që mos të shkelen të drejtat e njeriut dhe të drejtat e pakicave dhe cilit do personi në Kosovë, pa marrë parasysh prejardhjen e tyre fetare apo kombëtare.

ME RËNDËSI

Miratimi i këtij amendamenti kërkon plotësimin e tekstit në versionin në gjuhën shqipe dhe angleze, përkatësisht shtimi i tekstit të theksuar në amendament.

Amendamenti VIII

Nenit 11, i shtohet paragrafi 8, si në vijim:

Dispozitat e këtij neni nuk do të zbatohen në patundshmëritë të cilat janë ndërtuar deri në vitin 2004, e pronarët e të cilave janë personat e shpërngulur apo personat të cilët për çfarëdo shkak të arsyeshëm nuk kanë qasje në pronën e tyre ose personat të cilëve prona e tyre është lëndë e uzurpimit

ARSYETIM

Kuptimi i kësaj dispozite është që pronari, i cili nuk ka qenë në gjendje që të paraqesë kërkesë për legalizim ose nuk ka fare qasje në pronën e tij, e jo rrallë herë nuk kanë qasje as në Kosovë, mos të dënohen për shkak se, rrethanat të cilat kanë të bëjnë me të njëjtin paraqesin rrethanat e mbi fuqisë, dhe nuk ka mundur të paraqesë kërkesë për legalizimin e pronës së tij të paluajtshme.

ME RËNDËSI

Miratimi i këtij amendamenti kërkon plotësimin e tekstit në versionin në gjuhën shqipe dhe angleze, përkatësisht shtimi i tekstit të theksuar në amendament.

Amendamenti IX

Nenit 15 i shtohet paragrafi 10, si në vijim:

Asgjë nga ky nen nuk mund të interpretohet në atë mënyrë që të jepet leja për përfundimin e ndërtimit si dhe as për përfundimin e adaptimit të cilit do lloji, i cili ka filluar në pronën e paluajtshme e cila ka qenë edhe më tej lëndë e uzurpimit, përkatësisht pronës të cilën pronari

për çfarë do rrethane të arsyeshme nuk ka qasje, si dhe në tokën ndërtimore urbane në të cilën janë ndërtuar patundshmëritë të cilat janë rrënuar si pasojë e veprimit të njeriut gjatë ose pas konfliktit, çrregullimeve ose akteve individuale jo legale.

ARSYETIM

Për dallim nga nenet e mëparshme, në këtë nen vazhdimi i ndërtimit trajtohet në atë mënyrë që për lejen për përfundimin e punimeve nuk është e nevojshme të sigurohet dëshmia për pronësinë ose lejen e shfrytëzimit në tokën në të cilën ndërtohet patundshmëria, e as asgjë tjetër që siguron se respektohen të drejtat e pronarëve të vërtetë të tokës së uzurpuar, përkatësisht të patundshmërive të uzurpuara. Në qoftë se ky nen mbetet në këtë formë, do të mundësojë hapësirë të gjerë për keqpërdorime, meqenëse të gjitha patundshmëritë e uzurpuara do të mund të shpallëshin patundshmëri të cilat janë në procesin e ndërtimit dhe në këtë mënyrë legalizohet gjendja të cila është ardhur me kryerjen e veprave penale, e jo rrallëherë edhe me dhunë fizike. Nuk ekziston asnjë rrethanë e arsyeshme që ky obligim mos të ekzistoj në ligj, përkatësisht që të pritët ndonjë udhëzim për zbatimin e ligjit në mënyrë që të konstatohet obligimi se leja i jepet vetëm pronarit legal të patundshmërisë.

ME RËNDËSI

Miratimi i këtij amendamenti kërkon plotësimin e tekstit në versionin në gjuhën shqipe dhe angleze, përkatësisht shtimi i tekstit të theksuar në amendament.

Amendamenti X

Neni 16 i shtohet paragrafi 6 si në vijim:

Asgjë nga ky nen nuk mund të interpretohet në atë mënyrë që të jepet leja për ndërhyrje, e cila është filluar në pronën e paluajtshme e cila ka qenë edhe më tutje lëndë e uzurpimit, përkatësisht prona në të cilën pronarët në çfarëdo rrethane të arsyeshme nuk kanë qasje.

ARSYETIM

Si edhe në nenin e mëparshëm, as në këtë nen nuk ekziston obligimi i argumentimit të pronësisë për pronën e paluajtshme e cila është lëndë e adaptimit, e që është pikëpamje e sigurisë juridike dhe të sundimit të ligjit që është e palejueshme. Nuk ekziston asnjë rrethanë e arsyeshme që ky obligim mos të ekzistojë në ligj, respektivisht që të pritët ndonjë udhëzim për zbatimin e ligjit në mënyrë që të konstatohet obligimi që leja i jepet vetëm pronarit legal të patundshmërisë.

ME RËNDËSI

Miratimi i këtij amendamenti kërkon plotësimin e tekstit në versionin në gjuhën shqipe dhe angleze, përkatësisht shtimi i tekstit të theksuar në amendament.

Amendamenti XI

Ndryshohet neni 3 paragrafi 1 pika 1.23 si në vijim:

„Lista e pritjes “ lista e ndërtimeve pa leje të cilat janë identifikuar me këtë ligj, statusi i të cilave do të fillojë që të zgjidhet pas gjetjes së zgjidhjeve për çështje pronësore apo statusi i të cilave do të fillojë të zgjidhet në bazë të programeve të veçanta të cilat i përpilon Ministria, me pëlqimin e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim dhe të komunave në territorin e të cilave gjenden ndërtimet pa leje dhe të cilat do të aprovohen nga Qeveria, në përputhje me nenin 10 të këtij ligji.

ARSYETIM

Duke pasur parasysh se në listën e pritjes gjenden ndërtime pa leje të cilat janë ndërtuar në pronë publike, pronën shoqërore, tokën bujqësore të komasacionit, rajonet e mbrojtura dhe korridoret infrastrukturore, është e nevojshme që të gjithë faktorët relevant, të cilët kanë interes që të zgjidhet

çështja e ndërtimeve pa leje, të marrin pjesë dhe të japin pëlqimin para miratimit të programit të posaçëm.

ME RËNDËSI

Miratimi i këtij amendamenti kërkon plotësimin e tekstit në versionin në gjuhën shqipe dhe angleze, përkatësisht shtimi i tekstit të theksuar në amendament.

Amendamenti XII

Ndryshohet neni 4 paragrafi 1 pika 1.7 si në vijim:

Në afatin prej tri vitesh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, i propozohet Qeverisë, me pëlqimin e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim dhe komunave në territorin e të cilave gjenden ndërtimet pa leje, programet detale për mënyrën e zgjidhjes së çështjeve të ndërtimeve pa leje, të listuar në Listën e pritjes, në përputhje me nenin 1 paragrafi 1 i këtij ligji, të cilat shqyrtohen dhe miratohen nga ana e Qeverisë në afat prej 4 vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

ARSYETIM

Duke pasur parasysh rëndësinë e pronës në të cilën janë ndërtuar ndërtime pa leje është e nevojshme që të zgjaten afatet, në mënyrë që të gjinden zgjidhje më të përshtatshme dhe më optimale.

ME RËNDËSI

Miratimi i këtij amendamenti kërkon plotësimin e tekstit në versionin në gjuhën shqipe dhe angleze, përkatësisht shtimi i tekstit të theksuar në amendament.

Amendamenti XIII

Ndryshohet neni 5. paragrafi 6, kështu që shtohet pika 6.4 si në vijim:

E harton bazën e të dhënave të patundshmërisë, në bashkëpunim me komunat kompetente, në format përkatëse, të cilat kanë qenë ose edhe më tutje janë lëndë e uzurpimit, përkatësisht patundshmëritë e të cilave pronarët për çfarëdo arsye qoftë nuk kanë qasje, si dhe patundshmëritë të cilat janë ndërtuar në tokën ndërtimore urbane, por janë rrënuar si pasojë e veprimit të njeriut gjatë ose pas konfliktit, çrregullimeve ose akteve individuale jo legale, në mënyrë që këto patundshmëri të përjashtohen nga procedura e legalizimit.

ARSYETIM

Në mënyrë që të respektohet parimi i sundimit të ligjit, prona e personave të shpërngulur ose personave të cilët jetojnë në Kosovë, por nuk kanë qasje në pronë ose personat të cilët pronën e tyre e kanë pasur në tokën ndërtimore urbane, nuk guxon të jetë lëndë e kompensimit dhe legalizimit nga ana e personave tjerë. Në mënyrë që të sigurohet dhe që të mbetet kështu, dhe në mënyrë që të parandalohet edhe çfarëdo lloji i keqpërdorimit me rastin e legalizimit, është e nevojshme që të bëhet regjistri i pronës së këtillë dhe me këtë të lehtësohet puna edhe organeve të cilat marrin pjesë në procedurën e legalizimit, në mënyrë që të jenë të njoftuar se kjo pronë nuk guxon të jetë lëndë e çfarëdo lloji të legalizimit.

ME RËNDËSI

Miratimi i këtij amendamenti kërkon plotësimin e tekstit në versionin në gjuhën shqipe dhe angleze, përkatësisht shtimi i tekstit të theksuar në amendament.

Amendamenti XIV

Është e nevojshme që të ndryshohet Neni 17 i Ligjit.

ARSYETIM

Duke pasur parasysh rëndësinë e ndërtimeve të kategorisë së III, e cila përfshinë ndërtimet me rrezikshmëri të lartë dhe ndërtimet me rëndësi nacionale, është e domosdoshme që të përshkruhet procedura detale për legalizimin e tyre në kuadër të këtij ligji. Dispozita se procedura për ndërtimet e kategorisë së III do të rregullohet me akte nënligjore e rrënon parimin e sigurisë juridike, posaçërisht duke pasur parasysh se në ligji është paraparë procedura detale për legalizimin e ndërtimeve të kategorisë së I dhe kategorisë së II.

ME RËNDËSI

Miratimi i këtij amendamenti kërkon plotësimin e tekstit në versionin në gjuhën shqipe dhe angleze, përkatësisht shtimi i tekstit të theksuar në amendament.

Amendamenti XV

Fshihet neni 13 paragrafi 5 pika 5.4.

ARSYETIM

Borxhi i pazgjidhur dhe procesi i vështirë i kthimit të pronës, i cili ka lindur për shkak të konflikteve të armatosura shpërnguljes masive dhe të uzurpimeve masive, e këtë e dëshmojnë 42.749 kërkesa pronësore të paraqitura në Agjencinë e Kosovës për pronë, 18.500 procedura gjyqësore për kompensimin e pasurisë së shkatërruar të patundshme, dhjetëra mijëra procedura gjyqësore të cilat zhvillohen për kthimin e pronës së uzurpuar ose për anulimin e transaksioneve mashtruese dhe raportet e organizatave ndërkombëtare, siç është OSBE, tregojnë se kursesi nuk guxon të lejohet mundësia që personi i cili nuk është përshkruar si pronarë i tokës në të cilën është ndërtuar objekti jo legal të fiton të drejtën e pronës në tokën në të cilën gjendet objekti sipas një procedure të rëndomtë të cilën e parasheh Projektligji.

Zgjidhja e sipër theksuar do të mundësonte që personi, i cili e ka uzurpuar tokën e personit të shpërngulur ose personit tjetër të dëmtuar dhe ka rrënuar objektet e pronarit të tokës, pasi që në mënyrë jo legale është ndërtuar objekti në tokën e uzurpuar me legalizimin e këtij objekti bëhet pronar i kësaj toke sipas një procedure të rëndomtë administrative.

ME RËNDËSI

Miratimi i këtij amendamenti kërkon plotësimin e tekstit në versionin në gjuhën shqipe dhe angleze, përkatësisht shtimi i tekstit të theksuar në amendament.

Amendamenti XVI

Fshihet neni 14 paragrafi 3 pika 3.5.

ARSYETIM

I njëjti arsyetim si për Amendamentin XV.

ME RËNDËSI

Miratimi i këtij amendamenti kërkon plotësimin e tekstit në versionin në gjuhën shqipe dhe angleze, përkatësisht shtimi i tekstit të theksuar në amendament.

Amendamenti XVII

Fshihet neni 15 paragrafi 7 pika 7.3.

ARSYETIM

I njëjti arsyetim si për Amendamentin XV.

ME RËNDËSI

Miratimi i këtij amendamenti kërkon plotësimin e tekstit në versionin në gjuhën shqipe dhe angleze, përkatësisht shtimi i tekstit të theksuar në amendament.

Amendamenti XVIII

Fshihet neni 16 paragrafi 3 pika 3.5.

ARSYETIM

I njëjti arsyetim si për Amendamentin XV.

ME RËNDËSI

Miratimi i këtij amendamenti kërkon plotësimin e tekstit në versionin në gjuhën shqipe dhe angleze, përkatësisht shtimi i tekstit të theksuar në amendament.

Amendamenti XIX

Në nenin 11, shtohet pika 1.4 si në vijim:

Ndërtimet e ndërtuara në pronën e paluajtshme e cila ka qenë apo është edhe më tutje lëndë e uzurpimit, përkatësisht prona të cilës pronarët për çfarëdo arsye nuk kanë qasje, si dhe tokës ndërtimore urbane në të cilën janë ndërtuar patundshmëri e të cilat janë rrënuar si pasojë e veprimit të njeriut gjatë ose pas konfliktit, çrregullimeve dhe akteve jo legale individuale.

ARSYETIM

Në mënyrë që të parandalohet çfarëdo lloji i keqpërdorimit në procesin e legalizimit, është e nevojshme që të përcaktohet në mënyrë të qartë që objekti i ndërtuar në pronën e paluajtshme e cila ka qenë ose edhe më tutje është lëndë e uzurpimit, përkatësisht pronës të cilës pronarët për çfarëdo arsye qoftë nuk kanë të drejtë qasjeje, si dhe në tokën ndërtimore urbane në të cilën kanë qenë të ndërtuara patundshmëritë të cilat janë rrënuar si pasojë e veprimit të njeriut gjatë ose pas konfliktit, çrregullimeve ose akteve individuale jo legale nuk guxon të jetë lëndë e legalizimit dhe duhet të rrënohet. Me këtë zgjidhje ligjore iu dërgohet një mesazh i qartë uzurpatorëve se uzurpimet e tyre të pronës së huaj do të sanksionohen dhe mënjanohen pengesat e konsiderueshme për kthimin e personave të shpërngulur, në qoftë se në tokën e tyre është rrënuar objekti i ndërtuar në mënyrë jo legale.

ME RËNDËSI

Miratimi i këtij amendamenti kërkon plotësimin e tekstit në versionin në gjuhën shqipe dhe angleze, përkatësisht shtimi i tekstit të theksuar në amendament.

Mbledhja përfundoi në orën 12,04.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Daut Haradinaj